



UBT News

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji - Prill 2009



• Gjashtë botime të reja të UBT-së • “Prishtina Capital”, edhe një botim i ri i UBT-së • Pjesëmarrje e madhe dhe debat përmbajtësor në konferencën ndërkombëtare “Eficienca e energjisë për Kosovën përmes ndërtesave të qëndrueshme” • Shumë rezultate e edhe më shumë plane në studimet e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor • Duli: UBT - universiteti i parë në tërë Ballkanin që ka hapur studimet për Master për Prokurim Publik dhe Menaxhment • Ambasadori La Porta diskuton me studentët e UBT-së • UBT anëtarësohet në ITA • Brezat e të diplomuarve në UBT në pozita udhëheqëse dhe me sukses të pakontestueshëm

Në UBT u organizua edhe një konferencë ndërkombëtare

Pjesëmarrje e madhe dhe debat përmbajtjesor në konferencën “Eficienca e energjisë për Kosovën përmes ndërtesave të qëndrueshme”

Konferenca u përcoll nga një numër i konsiderueshëm të interesuarish, profesorë dhe studentë e përfaqësues të Alumnit të UBT-së, pastaj profesorë nga Universiteti i Prishtinës dhe universitete e fakultete të tjera. Ishin po kështu të pranishëm edhe mysafirë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, si dhe përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Minierave e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

“Eficienca e energjisë për Kosovën përmes ndërtesave të qëndrueshme” ishte konferenca ndërkombëtare e radhës, e organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Organizuar nga Departamenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, në koordinim me Partnerët Ndërkombëtarë, konferenca “Eficienca e energjisë për Kosovën përmes ndërtesave të qëndrueshme” solli në debat ekspertë eminentë ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët me trajtesat e tyre elaboruan temën e shtruar nga aspekte të ndryshme. Konferenca u përcoll nga një numër i konsiderueshëm të interesuarish, profesorë dhe studentë e përfaqësues të Alumnit të UBT-së, pastaj profesorë nga Universiteti i Prishtinës dhe universitete e fakultete të tjera. Ishin po kështu të pranishëm edhe mysafirë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, si dhe përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Minierave e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Vlerësuar nga pjesëmarrja e gjerë, por edhe nga studimet serioze e me peshë shkencore të paraqitura në konferencë,

nga pjesëmarrësit dhe auditori ajo u vlerësua shumë e suksesshme.

Me një fjalë rasti në fillim të konferencës u paraqitën Dr. Edmond Hajrizi, President i Universitetit për Biznes dhe Teknologji dhe Dipl.Ing.Dr.tech. Thomas Hrabal-MSc, dekan i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT.

“Ndërtimi i Shtëpisë Passive Standardet dhe Zhvillimet në Austri” ishte tema në të cilën foli Ernst Heiduk, nga Carinthia University of Applied Sciences, derisa “Projekt Menaxhmenti i Qëndrueshëm” ishte tema që elaboroi Dr.Thomas Hrabal nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji.

Në temën “Hapi i Dytë Drejt Shtëpisë Passive” elaborimet e tyre rreth kësaj teme i paraqitën Sadije Deliu, Blerta Vula, Gent Hasimja, Kreshnik Muhaxheri, studentë të Master-it në UBT, ndërsa Dip.Ing. Nexhat Jashari nga GTZ elaboroi temën “Eficienca e Energjisë - Roli i Komunave”, derisa në temën “Potenciali i Materialeve për Ndërtim të Qëndrueshëm” foli Erëin Schëarzmuller nga Eco Building Cluster Austria.

“Qëndrueshmëria në Arkitekturën Tradicionale Kosovare” e titulloi paraqitjen e saj Dr. Caroline Jager- Klein, nga Universiteti i Vjenës për Teknologji, ndërsa Petrit Ahmeti, student i Master-it në UBT, foli në temën “Përkthimi i PHP Softuerit në Gjuhën Shqipe”.

Në vijim, arkitekti nga Vjena Gerhard Kopeining foli në temën “Potencialet e Renovimeve – Shembuj në Austri”, Dip.Ing.Naim Mahmutaj, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë foli për “Certifikimin e Produkteve Ndërtimore Sipas Direktivës Europiane”, ndërsa në përmbyllje, për “Hapat e Parë të Planifikimeve në Lidhje me Eficiencën e

Energjisë në Kosovë”, folën Dr.Edmond Hajrizi dhe DI Ernst Heiduk,.

Duke paraqitur konkluzionet e konferencës, bashkëdrejtues i Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, MSc.Dipl.Ing.Binak Beqaj vlerësoi se: “Në bazë të rekomandimeve që dolën nga përmbajtja e punimeve të paraqitura në konferencë, rrjedh që konferenca u cilësua si shumë e suksesshme, veçanërisht me kontributet e autorëve të prezantimeve, që mund të konsiderohen si udhërrëfyes i mirë për politikën e institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e projekteve dhe ndërtesave të qëndrueshme”.


Prishtina Capital”, edhe një botim i UBT-së

“Prishtina Capital”, një botim për arkitekturën dhe planifikimin hapësinor, është publikimi më i ri në kuadër të serisë së publikimeve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Ai përfshin punimet e studentëve vitit akademik 2005/2006 të Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të UBT-së.

Libri është botuar në përkujdesjen e Ursula Faix e Paul Burgs taller, për pamjen teknike është përkujdesur Chris Conrardy, përmbajtjes i paraprijnë editorialët e Prof.Dr.Edmond Hajrizit, Dr.Thomas Hrabalit, Dipl.Ing.Georg Grasserit dhe MSc.Dipl. Ing.Binak Beqajt, ndërsa në të përfshihen punimet e autorëve: Fidan Belegu, Minire Bllaca, Ermal Buçinca, Albulena Dashaj, Mirushë Ejupi, Arben Islami, Kushtrim Ismajli, Florim Krasniqi, Leana Mahmuti, Dardan Metushi, Adrian Muhadri, Uran Ramadani e Hasan Canolli.

Libri përmban projekte e harta të zhvillimit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, si dhe një vistër të tërë fotografish të Prishtinës së sotme, parë nga perspektiva e editorëve dhe stu-



dentëve, fotografi që dallohen me një qartësi dhe përmbajtje artistike, që i japin lexuesit, qoftë ai i huaj apo kosovar, një pamje shumë të mirë për kryeqytetin e ditëve të sotme, me të gjitha bukuritë dhe të mangësitë prezente në të.

Botimi “Prishtina Capital” u sponsorizua nga Ministria e Austrisë për Mësim, Art dhe Kulturë.

Sipas planit botues të UBT-së

Gjashtë botime të reja të UBT-së

Titujt e rinj të botuar nga UBT janë: “Kosova post-status challenges” - Political Aspect- (Sfidat passtatusore të Kosovës – Aspekti politik); “Kosova post-status challenges” - Economical Aspect - Sfidat passtatusore të Kosovës - Aspekti ekonomik); Automation Day - Automation and Mechatronics (Dita e Automatikës – Automatika dhe Mekatronika); Architecture, Spatial Planning, International Experiences and Challenges in Kosova (Arkitektura dhe Planifikimi Hapësinor, Përvojat ndërkombëtare dhe sfidat në Kosovë); “Ndërmarrja moderne: Menaxhment – Inxhinieri – Kompjuterizëm” dhe “Rekomandime nga Forumi i Dytë Ndërkombëtar: “UBT - Kosova Go International

Gjashtë tituj të rinj sjell UBT në vazhden e veprimtarisë së tij botuese. Pas botimit të librit “Prokurimi publik në Kosovë”, të autorit Ilaz Duli, UBT botoi edhe përmbledhjet e gjashtë konferencave ndërkombëtare, organizuar nga UBT dhe me pjesëmarrje të ekspertëve e profesorëve eminentë nga vendi e bota.

Titujt e rinj të botuar nga UBT janë:

- “Kosova post-status challenges” - Political Aspect- (Sfidat passtatusore të Kosovës – Aspekti politik),
- “Kosova post-status challenges” - Economical Aspect - Sfidat passtatusore të Kosovës - Aspekti ekonomik),
- Automation Day - Automation and Mechatronics (Dita e Automatikës – Automatika dhe Mekatronika),
- Architecture, Spatial Planning, International Experiences and Challenges in Kosova (Arkitektura dhe Planifikimi Hapësinor, Përvojat ndërkombëtare dhe sfidat në Kosovë),



- “Ndërmarrja moderne: Menaxhment – Inxhinieri – Kompjuterizëm” dhe
- “Rekomandime nga Forumi i Dytë Ndërkombëtar: “UBT - Kosova Go International.

“Kosova post-status challenges” - Political Aspect- (Sfidat passtatusore të Kosovës – Aspekti politik), është libri i dytë që sjell punimet kryesore të paraqitura në kuadër të konferencës me të njëjtin emër, organizuar nga UBT më 13 maj 2008. Politika e jashtme e Kosovës, strategjia e kësaj politike, procesi i decentralizimit dhe një krahasim i Dokumentit të Marti Ahtisarit me dokumentet tjera

ndërkombëtare në Ballkan janë disa nga temat që shtjellohen nga autorë të njohur vendorë e ndërkombëtarë, në këtë botim të UBT-së. Mes të tjerësh, për këto tema shkruajnë Prof.dr.Ernst Florian Vinter, Dr. iur. Mengistu Arefaine, Mentor Nazarko e Burim Breznica.

“Kosova post–status challenges” - Economical Aspect - Sfidat passtatusore të Kosovës - Aspekti ekonomik), është publikimi tjetër që sjell UBT. Në të janë përmbledhur punimet më interesante, të paraqitura në konferencën e organizuar më 28 maj 2008. Autorë vendorë dhe ndërkombëtarë, pjesëmarrës në konferencë kanë paraqitur aty qasjet e tyre për sfidat ekonomike të shtetit të ri, duke dhënë dhe rrugëzgjdhjet për rrugët që duhet të ndjekë Republika e Kosovës për të siguruar një rritje të shëndoshë ekonomike dhe për t’u bërë pjesë e botës së përparuar. Publikimi sjell punimet e e këtyre autorëve: Hajdar Grezda, Valon Murtezaj, Bashkim Arifi, Behxhet Brajshori, Mukesh Bhargava, Agim Shahini, Levent Koro, Arton Celina, Azem Rexhaj, Megzon Nela, Mustafë Hasani e Edmond Hajrizi.

Automation Day - Automation and Mechatronics (Dita e Automatikës – Automatika dhe Mekatronika), sjell përmbledhjen e konferencës së organizuar në UBT më 11 qershor 2008. Hulumtimet në fushën e robotikës dhe të automatikës, dy fusha këto të reja, të ofruara në Kosovë nga UBT, të ofruara nga autorë të huaj dhe vendorë, sjellin të dhëna mjaft interesante nga një fushë që po hedh hapat e saj të parë në vendin tonë. Publikimi sjell punimet e autorëve: Dr. Larry Stapleton, Marco Ceccarelli, Edmond Hajrizi, Arbnor Pajaziti, Shefqet Avdiu e Dr.sc. Shkelzen Caka Architecture, Spatial Planning, International Experiences and Challenges in Kosova (Arkitektura dhe Planifikimi Hapësinor, Përvojat ndërkombëtare dhe sfidat në Kosovë) ishte konferenca e radhës e organizuar

në UBT, më 26 qershor 2008. Duke qenë institucioni që ofron studimet më të avancuara në fushën e arkitekturës në Kosovë, UBT ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me një varg universitetesh prestigjioze ndërkombëtare të kësaj fushe. Përfaqësues të këtyre universiteteve, si dhe profesorë, studiues e studentë nga vendi paraqitën punimet e tyre në konferencë, të cilat sillen para lexuesit në një botim të veçantë. Autorët që prezantohen në këtë publikim janë: Kingsbury Marzolf, MSc.Dipl.Ing. Binak Beqaj, Arch. Besa Jagxhiu, Arch. Ferhat Bejtullahu, Florina Jerliu, architect, Ilirjana Mejzini, Prof. Dipl. Ing. Dr. tech. Caroline Jäger-Klein, Dr. Thomas Hrabal, Dr.sc. Flamur Doli, B.Vula, S.Kelmendi, G.Hasimja, P.Ahmeti, K.Muhaxheri, V.Rexhepi, Arch.Edmond Tafarshiku e Ramë Hamzaj.

“Ndërmarrja moderne: Menaxhment – Inxhinieri – Kompjuterizëm” është publikimi i radhës që sjell UBT në këtë seri botimesh dhe sjell të gjitha publikimet e paraqitura në konferencën me të njëjtin titull, të organizuar në UBT më 6 e 7 nëntor 2008. Në publikim kanë zënë vend punimet e këtyre autorëve: Kurt Schlacher, Johannes Kepler, Peter Kopacek, Riko Safaric, Marco Ceccarelli, Guisepe Carbone, Martin Kornfeld, Arbnor Pajaziti, Shaban Buza, Edmond Hajrizi, Artan Dermaku, Nayden Chivarov, Lindita Tahiri, Mathias Winker, Jan Wikander, Abdelhamed Magdy, Larry Stapleton, Johannes Kepler, Naser Graiçevci, Artan Celina, Anita Kealy e Milaim Retkoceri. “Rekomandime nga Forumi i Dytë Ndërkombëtar: “UBT - Kosova Go International” është përmbledhje e konferencës organizuar në UBT nga 11-18.06.2006. Folës në konferencë, mes të tjerësh, ishin edhe Agim Çeku, Bajram Kosumi, Nuredin Ibishi, Bejtush Gashi, Edita Tahiri, Behxhet Brajshori, e përfaqësues të tjerë të institucioneve e ekspertë të fushave të ndryshme. ●

Dipl.Ing.Binak Beqaj, bashkëdrejtues i Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT

Shumë rezultate e edhe më shumë plane në studimet e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor

Në fillim të korrikut 2009 do të organizojmë vizitën studimore në Vjenë, për studentët e Arkitekturës. Vizita organizohet në bashkëpunim me TU-Vjenë me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave me studentët dhe profesorët atje në shumë fusha të zhvillimeve arkitektonike

- Z.Beqaj, si ka rrjedhë ky vit akademik në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor. Si janë zhvilluar përgatitjet për fillimin e tij dhe çfarë risish ka pasur këtë vit në krahasim me vitet tjera?

Beqaj: Meqenëse ky është viti i katërt i funksionimit të Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, këtë vit përgatitjet për fillimin e vitit të ri akademik kanë shkuar më mirë, për shkak të organizimit më të mirë, përvojës së krijuar etj. Edhe pse këtë fillimviti kemi qenë të hendikepuar nga vendimi joparimor për moslejimin e regjistrimit të studentëve të rinj, gjithsesi përkushtimi ynë për t'u konsoliduar në drejtim të ngritjes së kualitetit në administrim, mësimdhënie dhe mësimnxënie ka qenë evident. Në këtë aspekt vlen të përmendet hartimi dhe harmonizimi i orareve mësimore si dhe shpërndarja me kohë tek studentët dhe mësimdhënësit. Sigurimi i stafit akademik më me shumë kualitete profesionale, qofte risistemimi i atij ekzistues apo pranimi i kuadrit të ri. Po ashtu vlen të ceket edhe rishqyrtimi dhe përmirësimi i syllabuseve për të gjitha lëndët nga Kurrikula. Pra, konkludojmë se fillimi i vitit akademik për nga aspekti organizativ ishte i suksesshëm.

- Në UBT, po edhe në departamentin që ju drejtoni, i kushtohet një rëndësi e madhe kontaktit të përhershëm me studentët, me theks të veçantë në



Dipl.Ing.Binak Beqaj, bashkëdrejtues i Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT

angazhimin për përmirësimin e cilësisë së studimeve. Çka është ndërmarrë në këtë drejtim?

Beqaj: Po është e vërtetë. Kësaj i paraprijnë takimet e rregullta me përfaqësuesit e studentëve apo edhe takimet e konsultimit me studentët. Qëllimi i këtyre takimeve është identifikimi i problemeve dhe propozim-identetë për përmirësimin e sistemit. Edhe në këtë drejtim është bërë shumë në zgjidhjen e problemeve (numri më i madh i asistentëve, sallat më të mëdha për mësim, vizitat studimore brenda dhe jashtë vendit, salla e veçantë e kompjuterëve për arkitek-

turë, edhe pse mbetet për t'u përmirësuar performansa e kompjuterëve.

- Përveç mësimdhënies, ka pasur edhe angazhime të tjera, përfshirë edhe trajnimet, ekspozitat e ligjëratat e ndryshme. Cilat kanë qenë këto aktivitete, kur janë zhvilluar ato dhe cili ka qenë rezultati i tyre?

Beqaj: Në bazë të planifikimeve tona, përveç procesit mësimor, janë paraparë të zhvillohen edhe disa trajnime profesionale gjatë këtij viti. Gjer me tani është realizuar trajnimi Bazat e AutoCadit të cilin e kanë kryer 9 kandidatë të cilëve u janë ndarë certifikatat. Po ashtu është paraparë vazhdimi i mëtejme i trajnimeve. Më 06.04.2009 është hapur ekspozita e punimeve të studentëve Master, në lidhje me projektet e tyre për planin zhvillimor-urban të Lypjanit. Kurse, në fillim të qershorit 2009 do të organizohet ekspozita e punimeve (dizajneve) të studentëve Bachelor nga lëndët projektuese gjatë vitit akademik 2008/2009.

- Departamenti juaj ka shënuar rezultate edhe në fushën e publikimeve. Për cilat publikime është fjala?

Beqaj: Këtë vit kemi bërë dy publikime. E para "Prishtina Capital" ku trajtohen aspektet e gjendjes ekzistuese urbane bazuar në hulumtimet e grupeve të studentëve dhe vlerësimet e disa profesorëve. E dyta është publikimi nga prezantimet e pjesëmarrësve në Konferencën Shkencore të organizuar në UBT me temën "Planifikimi Hapësinor, Përvojat Ndërkombëtare dhe Sfidat në Kosovë". Konferenca është organizuar në qershor 2008 dhe në këtë publikim janë 12 punime.

- Keni qenë të angazhuar edhe në internshipin e studentëve. Çka është punuar në këtë drejtim?

Beqaj: Në lidhje me këtë, tani kemi krijuar një traditë për internshipin e studentëve me qëllim të ndërlikohjes sa më të mirë të teorisë nga studimet me praktikën profesionale. Edhe këtë vit në bazë të memorandumit të mirëkuptimit me kompaninë "Tregtia" kemi organizuar internshipin e 9 studentëve tanë atje duke filluar nga 15 marsi gjer më 15 korrik 2009. Studentët do të kryejnë disa orë në organizim të biznesit

disa në projektim dhe disa në mbikëqyrje në punishte.

- Besojmë se edhe këtë vit, sikur edhe në vitet paraprake, keni organizuar vizita studimore në institucionet partnere në botë. Çka keni planifikuar për këtë vit?

Beqaj: Në fillim të korrikut 2009 do të organizojmë vizitën studimore në Vjenë, për studentët e Arkitekturës. Vizita organizohet në bashkëpunim me TU-Vjenë me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave me studentët dhe profesorët atje në shumë fusha të zhvillimeve arkitektonike.

- Sikur edhe çdo vit tjetër, Departamenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor organizoi edhe këtë vit një konferencë ndërkombëtare. Kur do të organizohet kjo konferencë, cila do të jetë tema e saj dhe kush do të jenë pjesëmarrësit?

Beqaj: Kjo konferencë u organizua më 07.04.2009 në UBT. Tema e saj ishte jetë "Eficienca e Energjisë për Kosovën në Raport me Ndërtesat e Qëndrueshme". Pjesëmarrës do të qenë ekspertë ndërkombëtarë nga Austria dhe ekspertë vendorë, fushëveprimtaria e të cilëve ndërlikohet me tematikën. Qëllimi i organizimit të kësaj konference është sensibilizimi i shoqërisë kosovare (komunitetit dhe institucioneve) në lidhje me ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të energjisë, duke u bazuar në konceptet zhvillimore të shoqërive të zhvilluara.

- Cilat janë planet e zhvillimit të këtij departamenti në të ardhmen?

Beqaj: Departamenti ynë, tani e ka mirë të stabilizuar sistemin e studimeve Bachelor dhe Master. Prioritet për këtë vit, pas akreditimit, do të jetë regjistrimi i studentëve të rinj. Do të organizojmë një debat të gjerë më ta që t'ua sqarojmë të arriturat tona që janë të pakrahasueshme jo vetëm për nivelin e Kosovës por edhe më gjerë. Po ashtu, edhe përmirësimi i vazhdueshëm kualitativ i kushteve të studimit është prioritet për neve.

Këtë vit kemi filluar edhe me Institutin e Projektimeve, ku do të jetë një shans i mirë edhe për stafin e edhe për studentët që të dëshmojnë aftësitë e tyre kreative-krijuese në lëmin e projektimit. ●

Ilaz Duli flet për gazetën “UBT news”

Duli: UBT - universiteti i parë në tërë Ballkanin që ka hapur studimet për Master për Prokurim Publik dhe Menaxhment

UBT ka dhënë një kontribut të theksuar në zhvillimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, për arsye se është Universiteti i parë në Kosovë e me siguri edhe në tërë Ballkanin, i cili ka hapur studimet për Master në drejtimin për Prokurim Publik dhe Menaxhment

- Z.Duli, para disa kohësh ju keni botuar librin “Prokurimi Publik në Kosovë”. Çka përmban ky libër?

Duli: Libri Prokurimi Publik në Kosovë është botuar në dhjetor të vitit 2008 dhe ky është libri i parë i botuar nga kjo fushë në gjuhën shqipe. Në këtë libër jam përpjekur të pasqyroj një analizë të detajuar të zhvillimit të deritanishëm të sistemit të prokurimit publik, reformat që kanë ndodhur në sistemin e prokurimit publik në Kosovë që nga themelimi i tij, si dhe një analizë të detajuar statistikore të aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë, me koncentrim të veçantë në vitin 2007. Përfitimet më të mëdha që kam pasur për përgatitjen e këtij punimi kanë qenë përvoja ime praktike, me të cilën jam ballafaquar gjatë kësaj periudhe në fushën e prokurimit publik, duke pasur parasysh se kam qenë i angazhuar në institucionet e prokurimit publik në Kosovë që nga fillimi i paraqitjes së prokurimit publik në Kosovë. Natyrisht, jam përpjekur të shfrytëzoj të gjitha njohuritë që kam fituar gjatë kësaj periudhe në fushën e prokurimit publik, punës së përbashkët dhe kontakteve të përditshme me ekspertët ndërkombëtarë të prokurimit në fushën e prokurimit publik që kanë punuar në Kosovë, mandej gjatë punës sime në grupet punuese për përgatitjen e legjislacionit mbi prokurimin publik në Kosovë, si atij paraprak, ashtu edhe këtij ekzistues, si dhe të gjitha njohuritë që kam arritur t'i fitoj gjatë pjesëmarrjes në trajnimet dhe aftësimet e ndryshme, si dhe pjesëmarrjen në konferencat e mbajtura mbi prokurimin publik, si në nivel regional ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.



Mr.Sc. Ilaz Duli, kryetar i KRPP dhe autor i librit “Prokurimi Publik në Kosovë”

- Kush është botues i librit dhe kush e ka ndihmuar atë në procesin deri te ardhja në duar të lexuesit?

Duli: Botues i librit është Universiteti për Biznes dhe Teknologji i Prishtinës.

Përpos botimit të këtij libri, UBT-ja ka dhënë një kontribut të theksuar në zhvillimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, për arsye se është Universiteti i parë në Kosovë e me siguri edhe në tërë Ballkanin, i cili ka hapur studimet për Master në drejtimin për Prokurim Publik dhe Menaxhment. Unë kam pasur fatin që të jem vijues i gjeneratës së parë të këtyre studimeve që kanë filluar në dhjetor 2005, kurse temën e magjistraturës e kam mbrojtur me sukses në shtator 2007. Shtypjen e librit e ka financuar Qeveria Zvicerane, përmes projektit LOGOS Swiss-Kosovo, e që ka për synim mbështetjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimin në Kosovë, dhe kjo ka ndihmuar që libri të arrijë në duar të lexuesit.

- Z.Duli, fusha e prokurimit është një fushë e re në Kosovë. Kur janë vënë themelet e prokurimit në vendin tonë dhe cila ka qenë rruga e zhvillimit të deritashëm të kësaj fushe?

Duli: Prokurimi publik në Kosovë është një lëmi relativisht e re. Ka filluar të zhvillohet menjëherë pas përfundimit të luftës së vitit 1999 dhe deri tani ka një jetëgjatësi rreth tetëvjeçare. Nëse krahasohen të arriturat e deritanishme në fushën e prokurimit publik në Kosovë me kohën e kaluar, që nga paraqitja e prokurimit, mund të arrihet deri te konkludimi se brenda një kohe kaq të shkurtër janë arritur rezultate të konsiderueshme.

Faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate mund të kategorizohen në dy grupe: a) Menjëherë pas luftës, në fushën e prokurimit publik në Kosovë janë angazhuar një numër mjaft i madh i ekspertëve ndërkombëtarë të prokurimit, të cilët kanë themeluar sistemin e prokurimit publik në Kosovë. Ata në fillim edhe kanë kryer të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, si dhe kanë aftësuar zyrtarët kosovarë të prokurimit, të cilët në fazat fillestare kanë qenë në rolin e asistentëve.

b) Duke pasur parasysh prokurimin publik si një fushë të re në Kosovë, shumë donatorë të ndryshëm kanë ofruar fonde për trajnimin e zyrtarëve kosovarë të prokurimit, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Kështu, një numër mjaft i madh i zyrtarëve kosovarë të prokurimit kanë ndjekur trajnime të ndryshme nga fusha e prokurimit dhe përvojat e fituara gjatë këtyre trajnimeve i kanë bartur në Kosovë, në zhvillimin dhe në avancimin e sistemit të prokurimit publik.

- Ju jeni zyrtari i parë kosovar i angazhuar në fushën e prokurimit. Si e shihni nga perspektiva e tashme zhvillimin e prokurimit dhe cila mendoni se është e ardhmja e zhvillimit të kësaj fushe?

Duli: Lirisht mund të thuhet se brenda një kohe mjaft të shkurtër janë shënuar arritje të mëdha në themelimin e një sistemi krejtësisht të ri në Kosovë. Është kompletuar plotësisht legjislacioni mbi prokurimin publik në Kosovë, i cili mund të thuhet se është në përputhje me kërkesat që dalin nga Direktivat e Prokurimit të BE-së. Edhe legjislacioni dytësor është i kompletuar tërësisht. Një punë e theksuar është bërë edhe në trajnimin e zyrtarëve kosovarë që merren me prokurim publik, por fatkeqësisht numri i tyre është ende shumë i vogël në krahasim me nevojat për implementimin e suksesshëm të Ligjit për Prokurim Publik. Tani ka mbetur sfida më e madhe, ajo që ka të bëjë me implementimin e legjislacionit të prokurimit. Me angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve, beso se edhe implementimi i Ligjit në të ardhmen do të shënojë progres.

- Ju keni prezantuar Kosovën në disa takime shumë të rëndësishme për zhvillimin e prokurimit, por gjithashtu takime të kësaj natyre janë organizuar edhe në Kosovë. Na tregoni më shumë për këto takime dhe për rëndësinë e tyre?

Duli: Kam marrë pjesë në dhjetëra konferenca me karakter regional, evropian

dhe ndërkombëtar në fushën e prokurimit publik, ku edhe kam prezantuar të arriturat e prokurimit publik në Kosovë. Kam udhëhequr delegacionin kosovar në konferencat botërore mbi prokurimin publik në shtator 2006 në Romë të Italisë dhe në gusht 2008 në Amsterdam të Holandës. Gjithashtu kam udhëhequr delegacionin nga Kosova në konferencat vjetore mbi Rrjetin e Prokurimit Publik në Europë, në muajin maj 2005 në Lubjanë të Sllovenisë, në mars të vitit 2006 në Paris të Francës, dhe në prill 2007 në Varshavë të Polonisë.

Gjate shtatorit 2008 kam qenë udhëheqës i Konferencës Rajonale me temën "Reformimi i prokurimit publik në Ballkanin Perëndimor", e cila është mbajtur në Prishtinë. Ishte kjo njëra ndër ngjarjet më të rëndësishme në fushën e prokurimit publik në tërë Evropën gjatë vitit 2008. Pjesëmarrës të konferencës ishin përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të prokurimit publik nga rajoni i Ballkanit Perëndimor si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Turqia, mandej përfaqësuesit e KE nga Brukseli OECD/SiGMA nga Parisi, dhe përfaqësues dhe ekspertë të prokurimit nga shtete të ndryshme të Evropës. Në të gjitha këto konferenca janë prezantuar të arriturat e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Në prill të vitit 2008 kam prezantuar për herë të parë para Komisionit Evropian në Bruksel të arriturat në fushën e prokurimit publik në Kosovë. Nga viti 2008 jam gjithashtu edhe anëtar i PLAN - Rrjeti i akademikëve botërorë të prokurimit, ku janë të anëtarësuar 146 anëtarë akademikë nga të gjitha kontinentet.

- Cila është përgjithësisht rëndësia e prokurimit në Kosovë. Çka rregullon kjo fushë dhe cili është efekti i saj në sistemin e pagesave në vend?

Duli: Funkcionimi i sistemit të prokurimit publik paraqet një çështje

thelbësore të menaxhimit të financave publike për administratën publike në Kosovë dhe një sistem i mirëfilltë i prokurimit publik mundëson shfrytëzimin më efikas dhe më të arsyeshëm të fondeve publike, bazuar në transparencë, konkurrencë dhe trajtim të barabartë, duke mundësuar kursime substanciale të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe duke kontribuar ndjeshëm në ringjalljen dhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Prokurimi publik ka për qëllim të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në procesin e prokurimit.

- Z.Duli, çfarë mund të presim në të ardhmen nga ju, në fushën e prokurimit, apo edhe në fushat tjera të angazhimit tuaj?

Duli: Do të angazhohem me të gjitha potencialet e mia për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, natyrisht duke i shfrytëzuar të gjitha përvojat dhe njohuritë që kam arritur t'i kem nga kjo fushë deri tani. Kosova deri tani është e anëtarësuar në disa organizata ndërkombëtare të prokurimit, kurse do ta japë kontributin tim që Kosova të anëtarësohet sa më shpejt edhe në organizatat tjera të prokurimit, e sidomos në konferencën ndërkombëtare të prokurimit publik.

Edhe në fushën e botimit të librave të tjera nga fusha e prokurimit publik nuk do të mungojë angazhimi im. Tani për tani jam duke i bërë përgatitjet për publikimin e një libri tjetër nga fusha e prokurimit publik, i cili mendoj se do të titullohet Bazat e Prokurimit Publik. ●

Ambasadori amerikan në pension, Alphonse F. La Porta mban ligjëratë në Departamentin e Diplomacisë në UBT

Ambasadori La Porta diskuton me studentët e UBT-së

Ambasadori Alphonse F. La Porta aktualisht shërben si udhëheqës i ekipit këshillues në Ministrinë e Punëve të Jashtme, përmes “Development Alternatives International”, që financohet nga USAID-i

Në ligjëratën e para studentëve të Departamentit Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci në UBT, ambasadori amerikan në pension Alphonse F. La Porta bëri një rekapitullim kronologjik të zhvillimit të artit të diplomacisë nga koha e pararendesansës e deri tek Kongresi i Vjenës. Ai gjithashtu foli edhe për teknikat e ndikimit si në marrëdhëniet dypalëshe ashtu edhe në ato shumëpalëshe. Ai me tutje shtoi se një diplomat sot duhet të ketë tri attribute themelore



që ai e quajti “misioni i trefishtë”: Përfaqësimi, Operimi dhe Hartimi i politikave. Ambasadori Alphonse F. La Porta aktualisht shërben si udhëheqës i ekipit këshillues në Ministrinë e Punëve të Jashtme, përmes “Development Alternatives International”, që financohet nga USAID-i.

Diplomacia funksionale sot, shtoi më tutje ambasadori La Porta, kërkon më shumë angazhim, kërkon influencimin e opinionit publik përmes asaj që quhet diplomaci publike. Çështjet publike dhe diplomacia publike janë dy terme të cilat përdoren për të shpjeguar vetitë të cilat duhet t'i kenë diplomatët e sotëm për të artikuluar politikën e jashtme të vendit të tyre karshi opinionit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Me tutje ambasadori La Porta dhe studentët diskutuan mbi proceset aktuale që po zhvillohen në ngritjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, për nevojën e pasjes së një strategjie për politikën e jashtme të Kosovës dhe për procesin e përzgjedhjes së ambasadorëve në përfaqësitë e Republikës së Kosovës në botë.

Tryeza të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen nga Departamenti i Drejtësisë, Shkenca Politike dhe Diplomacisë në kuadër të UBT-së, u tha në fund të këtij takimi nga përfaqësuesit e këtij institucioni. ●

Intensifikohet bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së

UBT anëtarësohet në ITA

UBT është anëtarësuar në IAT (Teknologjia Informative për Industrinë Automobilistike), asociacion që përfshin mbi 780.000 punëtorë anembanë botës dhe gjeneron të hyra prej mbi 135 miliardë euro

UBT është anëtarësuar edhe në një institucion prestigjioz ndërkombëtar, duke qenë institucioni numër një i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës për anëtarësim dhe përfaqësim të shtetit të Kosovës në institucione e asociacione me renome ndërkombëtare.

Kësaj radhe, UBT është anëtarësuar në IAT (Teknologjia Informative për Industrinë Automobilistike), asociacion që përfshin mbi 780.000 punëtorë anembanë botës dhe gjeneron të hyra prej mbi 135 miliardë euro.

Vendimin për anëtarësimin e UBT-së e ka marrë Këshilli i Përgjithshëm i ITA-s, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2009.

Anëtarësimi në ITA, përveç peshës që ka me përfaqësimin e Kosovës në kuadër të këtij asociacioni, krijon edhe një varg përparësish dhe mundësish për ndërlidhje dhe punë në projekte të ndryshme profesionale dhe shkencore në kuadër të ITA-s si dhe mundësi për investime të huaja në Kosovë.



UBT anëtare e asociacionit që përfshin mbi 780.000 punëtorë anembanë botës dhe gjeneron të hyra prej mbi 135 miliardë euro

Prezantohet botimi i UBT-së mbi prokurimin publik

U përurua libri "Prokurimi Publik në Kosovë"

"Prokurimi Publik në Kosovë" është publikimi i parë për këtë fushë në Kosovë dhe vlerësohet kontribut shumë i madh për fushën e prokurimit, një fushë e re e zhvilluar në Kosovë në kohën e pasluftës


Libri "Prokurimi Publik në Kosovë", i autorit Mr.Sc.Ilaz Duli është botimi i ri që sjell UBT për publikun dhe studentët e tij. Ceremonia e përurimit të librit është organizuar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me pjesëmarrje personaliteteve të shumta nga vendi, nga misionet ndërkombëtare në Kosovë dhe mysafirë nga vendet Shqipëria e Mali i Zi.

"Prokurimi Publik në Kosovë" është publikimi i parë për këtë fushë në Kosovë dhe vlerësohet kontribut shumë i madh për fushën e prokurimit, një fushë e re e zhvilluar në Kosovë në kohën e pasluftës.

Duke qenë pjesë e zhvillimit të prokurimit në Kosovë që në fillet e tij, autori Ilaz Duli është ndër më meritorët për zhvillimin e prokurimit, zanafillën dhe rritën e të cilit ai e ka përmbledhur shumë mirë në librin e tij.

Recensentë, mysafirë dhe pjesëmarrës në promovim e kanë çmuar lart kontributin e z.Duli dhe e kanë uruar atë për botime të reja në këtë fushë.

Prof.Dr.Edmond Hajrizim, duke folur në emër të botuesit, por duke qenë edhe një nga recensentët e librit, ka thënë me këtë rast se UBT po përpiqet t'i ofrojë Kosovës dhe regionit programe të reja dhe me interes, ku hyn edhe libri i promovuar



Ballina e librit "Prokurimi Publik në Kosovë", e autorit Ilaz Duli, botuar nga UBT

për prokurimin publik.

Dr.Hajrizi theksoi se libri "Prokurimi Publik në Kosovë" i ofron lexuesit informacione burimore dhe shumë të rëndësishme për tërë procesin e zhvillimit të prokurimit publik në Kosovë që nga viti 1999 deri në vitin 2007.

"Libri do të kontribuojë në shtjellimin e fushës së prokurimit, në dhënien e informacioneve, për gjenezën dhe zhvillimin e kësaj fushe të re dhe shumë të rëndësishme në Kosovë", theksoi Hajrizi.

Recensenti tjetër i librit Bexhet

Brajshori, duke e quajtur librin mjaft përmbajtjesor, e ka shkoqitur përmbajtjen e tij kapitull për kapitull, duke shquar rëndësinë e tij, njëkohësisht duke uruar që autori edhe në të ardhmen të trajtojë këtë fushë shumë të rëndësishme në Kosovë.

Për disa nga vlerat e librit të përmendur folën edhe Xhon Fenigen, i cili që nga fillimi angazhohet në sistemin e prokurimit në Kosovë e në reformimin e tij, pastaj përfaqësuesja e Ambasadës Zvicerane në Kosovë Sylvia Shaer Hahn, e cila është angazhuar edhe në projektin “Logos”, nga i cili është financuar edhe botimi i librit të përruar. Në kontekst të librit foli edhe drejtoresha e Agjencisë së Prokurimit në Shqipëri Klodiana Cankja. Në fjalën e tij përshëndetëse autori i librit Ilaz Duli tha se në Kosovë, dokumenti i parë i cili e ka rregulluar fushën e prokurimit publik është nxjerrë nga Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë më 15.12.1999, i njohur si instruksioni i Administrimit Financiar mbi Prokurimin Publik, duke shfrytëzuar mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ky instruksion ka qenë i bazuar në rregullat e prokurimit të Bankës Botërore.

“Duke marrë parasysh se prokurimi është një fushë e re në Kosovë, që ka filluar të paraqitet menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, besoj se ky libër do ta japë kontributin e vet që lexuesit të pajisen me njohuritë e para lidhur me fushën e prokurimit publik”, tha z.Duli.

Autori Ilaz Duli në vitin 2007 ka përfunduar magistraturën në Universitetin për Biznes dhe Teknologji të Prishtinës në bashkëpunim me Universitetin për Teknologji të Vjenës në temën: “Zhvillimi dhe analiza e sistemit të prokurimit publik në Kosovë”.

Ai është personi i parë kosovar që filloi të

punojë në fushën e prokurimit publik në Kosovë që nga fillimi i vitit 2000. Nga vitet 2000 deri në 2002 ishte në pozitën e zyrtarit të prokurimit, kurse nga korriku i vitit 2002 deri në mars 2003 ishte Bashkëkryesues i Njësisë Qendrore të Prokurimit të Kosovës. Nga prilli 2003 deri në janar 2005 ishte Kryesues i Departamentit për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnime në fushën e prokurimit publik për tërë Kosovën. Në janar të vitit 2005 nga Kuvendi i Kosovës u emërua Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës, në të cilën pozitë ndodhet edhe tash.

Ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca me karakter regjional, evropian dhe ndërkombëtar në fushën e prokurimit publik, ku edhe ka prezantuar të arriturat e prokurimit publik në Kosovë. Ka udhëhequr delegacionin kosovar në konferencat botërore mbi prokurimin publik në shtator 2006 në Romë të Italisë dhe në gusht 2008 në Amsterdam të Holandës. Gjithashtu, ka udhëhequr delegacionin nga Kosova në konferencat me karakter evropian në fushën e prokurimit publik “Rrjeti i prokurimit publik në Europë”, në maj 2005, në Lubjanë të Sllovenisë, në mars 2006 në Paris të Francës, dhe në prill 2007 në Varshavë të Polonisë. Ka marrë pjesë në të gjitha konferencat vjetore mbi prokurimin publik në regjionin e Ballkanit Perëndimor që nga viti 2004 deri në vitin 2008. Ishte organizator dhe udhëheqës i konferencës regjionale mbi prokurimin publik në Ballkanin Perëndimor, e cila u mbajt në shtator 2008 në Prishtinë.

Në prill të vitit 2008, si anëtar i delegacionit nga Kosova, ka prezantuar për herë të parë para Komisionit European në Bruksel të arriturat në fushën e prokurimit publik në Kosovë. ●

Në vazhdën e marrëveshjeve për bashkëpunim me institucionet e ndryshme

UBT dhe BKUK vazhdojnë bashkëpunimin


Drejtues të këtyre dy institucioneve, dr.Sali Bashota dhe dr.Edmond Hajrizi, në një takim të zhvilluar më 27 shkurt, me nënshkrimin e një Memorandumit të Mirëkuptimi, kanë konfirmuar vazhdimin e bashkëpunimit të deritashëm dhe zgjerimin e fushës së bashkëpunimit, në kuadër të veprimtarisë së përbashkët dhe me qëllim të ndërlidhjes me institucione ndërkombëtare të kësaj fushe

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (BKUK) dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) do të vazhdojnë edhe më tej bashkëpunimin në shumë fusha.

Drejtues të këtyre dy institucioneve, dr.Sali Bashota dhe dr.Edmond Hajrizi, në një takim të zhvilluar më 27 shkurt, me nënshkrimin e një Memorandumit të Mirëkuptimi, kanë konfirmuar vazhdimin e bashkëpunimit të deritashëm dhe zgjerimin e fushës së bashkëpunimit, në kuadër të veprimtarisë së përbashkët dhe me qëllim të ndërlidhjes me institucione ndërkombëtare të kësaj fushe.

Ata kanë diskutuar rreth mundësisë së krijimit të një biblioteke të përbashkët digjitale, për projekte të përbashkëta në të gjitha fushat e bibliotekarisë, për bashkëveprim me institucionet e Vienës dhe mundësitë që ofron UBT-ja, si institucion me shumë partnerë ndërkombëtarë, për zgjerimin e fushës së komunikimit dhe të bashkëpunimit me institucione me renome ndërkombëtare nga fusha e bibliotekarisë.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me një varg institucionesh vendore, duke u ofruar atyre ekspertizën ndërkombëtare që ka si institucion me një numër shumë të madh të ekspertëve dhe profesorëve ndërkombëtare që ligjërojnë në këtë universitet, si dhe mundësinë e bashkëpunimit me një varg institucionesh



UBT e BKUK vazhdojnë bashkëpunimin në një varg fushash

ndërkombëtare, ku UBT është anëtarësuar, duke qenë në shumicën prej tyre si institucioni i vetëm i anëtarësuar jo vetëm nga Kosova por edhe nga rajoni. ●

UBT vazhdon bashkëpunimin me sektorin privat në vend

Studentët e Arkitekturës marrin certifikatat për internship

Në bazë të memorandumit të mirëkuptimit mes UBT-së dhe Kompanisë “Tregtia” dhe në bazë të programit të Fakultetit të Arkitekturës, që studimet teorike në fakultet të jenë sa më mirë të ndërlidhura me praktiken, është organizuar Internshipi i studentëve të vitit të tretë të Arkitekturës në këtë kompani. Secili student ka kryer 58 orë të ndara në këto fusha të veprimit: administrim biznesi, studio dizajn dhe mbikëqyrje të punimeve.

Më 30 janar 2009, në lokalet e UBT-së është organizuar ceremonia e ndarjes së certifikatave për studentët që me sukses kanë përfunduar këtë internship.

Në fjalën e rastit, bashkudhëheqësi i Departamentit të Arkitekturës në UBT,

ligjëruesi Binak Beqaj theksoi se kjo është një praktikë e mirë që siguron një vazhdimësi të ngritjes së kualitetit për ekspertët e ardhshëm të arkitekturës që arsimohen në UBT dhe dija e të cilëve do të jetë plotësisht e përputhshme me kërkesat e ekonomisë dhe zhvillimit jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Përfaqësuesi i kompanisë “Tregtia”, Mërgim Prishtina, duke falënderuar UBT-në për bashkëpunim, potencoi nivelin e lartë të dijes dhe angazhimit që kanë treguar studentët gjatë kryerjes së internshipit dhe si rezultat i kësaj njëri prej tyre është punësuar menjëherë në këtë kompani. Ai, po ashtu shprehu gatishmërinë që kjo praktikë e mirë të vazhdojë edhe në të ardhmen. ●

U organizua ligjërata tematike “Betoni i vetëngjeshur si material për ndërtimet e së ardhmes”

Studentët e UBT-së njihen me të arriturat e reja në fushën e ndërtimit

Organizuar nga Departamenti i Arkitekturës në UBT, u mbajt një ligjërata tematike në temën “Betoni i vetëngjeshur si material për ndërtimet e së ardhmes”. Në këtë temë foli eksperti i ndërtimitarisë, Driton Kryeziu, i cili në ligjëratën e tij u fokusua në karakteristikat e këtij materiali ndërtimor, i cili ka gjetur aplikim të gjerë në ndërtimtarinë e vendeve të zhvilluara (kryesisht për vepra madhore). Ky material ndërtimor në Kosovë konsiderohet si material i ri, por me mundësi të mëdha aplikimi për shkak të veçorive tekniko-teknologjike që i ka: Koha e

shkurtër e ngurtësimit, nga 28 ditë për betonin e thjeshtë në tri ditë për këtë beton; Shkurtimi i kohës për ngritjen e strukturave të betonit; Marka më e lartë e betonit që mundëson mbështetjen e konstruksioneve në distanca më të mëdha; Përmasat më të vogla të strukturave konstruktive; Angazhimi më i ulët i fuqisë punëtore në përpunimin e tij, që e ulë edhe koston; Tekstura e mirë homogjene etj.

Të pranishëm, studentët dhe profesorët, morën pjesë aktive në debatin e hapur në lidhje me këtë temë tejet interesante. ●

Portret: Ylberina Gashi, studente e UBT-së

Brezat e të diplomuarve në UBT në pozita udhëheqëse dhe me sukses të pakontestueshëm

“Për studentët e UBT-së do të ishte diçka shumë e çuditshme po të diskutohej akreditimi i këtij institucioni, ngase të gjitha kriteret e mundshme në fushën studimore i posedon dhe ku ka dëshmi më të madhe sesa brezat e të diplomuarve në këtë universitet, ku secili është në pozitë udhëheqëse dhe me një sukses të pakontestueshëm“, thotë Ylberina Gashi, studente në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, Fakulteti Business & Management, viti i dytë

Ylberina Gashi lindi dhe u rrit në Prishtinë. Mësimin fillor e përfundoi në shkollën “Meto Bajraktari” në Prishtinë dhe më pas vazhdoi shkollimin e mesëm në Gjimnazin “Sami Frashëri”, drejtimi i përgjithshëm. Periudha e shkollimit të saj i takon një faze reformiste që filloi të zhvillohej tek ne, duke filluar nga shtimi i klasës së IX-të, e cila ishte diçka krejt e re për vendin tonë, një formë krejtësisht ndryshe nga ajo siç ishim mësuar më parë, dhe më pas vazhdoi shkollimin e mesëm, i cili zgjati katër vjet. “Gjithë kjo periudhë, edhe pse mjaft afatgjate (9+4), ishte një mësim mjaft efikas që i përmbushi shumë e shumë hapësira të nevojshme për të gjitha fushat jetësore që një nxënësi i nevojiten. Meqenëse unë jam një person shumë eksplorues, gjithnjë në gatishmëri dhe dëshirë për të mësuar gjëra të reja, ishte një arsye që më bëri të jem një nxënëse e dalluar dhe me sukses të shkëlqyeshëm gjatë gjithë shkollimit tim fillor dhe të mesëm”, thotë Ylberina.

Për vendimin e saj që të studiojë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, ajo thotë: “Pasi përfundoi periudha e shkollimit të mesëm duhej të bëja një hap më tutje për të vendosur diçka më shumë në aspektin e zhvillimit profesional, duke përjetuar një periudhë shumë stresuese në kërkim të vendimi, më në fund hasa në një universitet që më impresionoi që në shikim të parë. Ishte pikërisht UBT që më bënte të veçoja nga alternativat tjera që kisha në dispozicion. Një universitet privat ndërkombëtar dhe me një staf profesionist,



Studentja Ylberina Gashi

me një plan-program krejt ndryshe nga ata që kisha hasur në universitetet tjera dhe, çka është më tërheqësja, ishte fakti që kishte profesorë të huaj nga shumë vende të botës, si Amerika dhe Evropa, të cilët mund ta transmetonin përvojën dhe realitetin botëror në vendin tonë. Gjithë studimi zhvillohej në gjuhën angleze, një element shumë me rëndësi në zhvillimin jetësor dhe profesional”.

Tutje Ylberina veçon faktin që ky universitet ishte në kërkim të studentëve kualitativë dhe të gatshëm për sfida, duke pasur parasysh që edhe motoja e UBT-së ishte “Succeed with Quality” dhe pikërisht dësh-

mia e kësaj thënieje ishte fakti që u krijonte hapësirë studentëve të dalluar të ishin pjesë e tij, ngase ky universitet mundësonte lehtësira për studime në formë burse për gjithë ata që donin të ishin pjesë e këtij universiteti dhe kishin një sukses të shkëlqyeshëm në shkollimin e mesëm. Edhe ajo u bë pjesë e këtij institucioni dhe tashmë është e gatshme për ballafaqimet e mëtutjeshme që e prisnin. Ajo u orientua në drejtimin Business & Management ngase e shihte veten më të përshtatur në këtë fushë.

Ajo e përfytyronte studimin me plot sfida dhe njohuri nga më të ndryshmet, gjë që ashtu edhe ndodhi. Që në hapat a parë të studimit ajo filloi të familjarizohet me këtë institucion. Nga dëshira që sadopak të kontribuojë në këtë drejtim filloi të aktivizohet në aspektin organizativ të studimeve, duke u zgjedhur si përfaqësuese e gjithë studentëve të vitit të parë. Kjo ishte edhe një fushë që e bëri të mishërohet edhe më afër me ndodhitë studimore, gjithashtu ishte një eksperiencë e re për të.

Përndryshe, në universitetin tonë, thotë Ylberina, është një përparësi që studentët në rast nevojë mund të qëndrojnë sa kohë që dëshirojnë brenda objektit, të shfrytëzojnë cilindo kabinet për nevoja studimore dhe gjithashtu të shfrytëzojnë bibliotekën e universitetit, që është në gatishmëri për çfarëdo lloj kërkese nga ana jonë. Kjo është edhe një përkrahje e rëndësishme që mua personalisht më ka ndihmuar shumë.

Kur është fjala për relacionet profesor-student, Ylberina ato i cilëson si jashtëzakonisht një relatë e shëndoshë, ngase për çfarëdo lloj sqarimi apo moskuptimi nga e studentëve mund të sqarohet shumë lehtë nga profesorët, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe në raste kur nuk janë prezent me anë të email-it, por gjithsesi secili nga profesorët ka një gatishmëri të jashtëzakonshme të kontribuojë në zhvillimin dhe përparimin tonë profesional në çfarëdo lloj mënyre të mundshme. Duke pasur parasysh që kuadri i profesorëve është i përbërë profesorë nga vende të ndryshme, ajo këtë e sheh si një mundësi që i është dhënë për të parë shumë më afër ndodhitë dhe realitetin botëror në të gjitha fushat.

Ylberina tanimë është në vitin e dytë, ka

një notë mesatare të lartë, ndërkohë që ajo u stimulua nga universiteti me një burse që i mundësohet secilit student që arrin të ketë sukses në fushën studimore.

Ylberina mendon dhe shpreson se po ky sukses dhe ky vullnet do ta përcjellë edhe në vitin në vijim ku edhe pret të përvetësojë dituri edhe nga sferat tjera që ajo i cilëson ende enigmë nga këndvështrimi i saj. Për të kjo do të jetë vazhdimi i përmbushjes së sfidave të përealizuara por shumë interesante. "Pjesëmarrja dhe angazhimi në aspektin studimor i ndihmon çdonjërit, në këtë rast mua personalisht, që të jem gjithnjë në hap me gjërat dhe dukuritë e reja në fushën e biznesit botëror", mendon Ylberina.

"Duke analizuar brendapërbrenda shtetit tonë situatën studimore në universitetet tjera (që janë me një numër mjaft të lart), absolutisht mund të them që vlen të veçohet emri i këtij universiteti (UBT), për shkak se dallon në të gjitha aspektet e mundshme qoftë organizative qoftë kualitative", thotë Ylberina. Këtë po e them jo pse jam pjesë e këtij universiteti, por nga këtu vërtet studimi është cilësor, shton ajo, dhe pas shumë vështirësive që ky institucion ka pasur gjatë vitit të fundit përsëri këto vështirësi nuk janë reflektuar në kualitetin që ai posedon.

"Për studentët e UBT-së do të ishte diçka shumë e çuditshme po të diskutohej akreditimi i këtij institucioni, ngase të gjitha kriteret e mundshme në fushën studimore i posedon dhe ku ka dëshmi më të madhe sesa brezat e të diplomuarve në këtë universitet, ku secili është në pozitë udhëheqëse dhe me një sukses të pakontestueshëm", thotë Ylberina Gashi.

"E vetmja gjë që mund të cek është që unë aspak nuk e vë në diskutim ardhjen time në këtë universitet, në fakt e përkrahi zgjedhjen time të parë dhe me instinkt të drejtë që e bëra", thotë Ylberina. Ajo mendon se ende nuk e ka arritur kulmin e zhvillimit ngase si pjesë e këtij institucioni i ka mbetur edhe më shumë për të dhënë dhe për të dëshmuar që me të vërtetë vlejme dhe do të bëjmë të pamundurën të kontribuojmë drejt zhvillimit dhe përmirësimit të kuadrove menaxhuese në vend.

Përgatiti: N. Demiri